



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 140, Datë 24.09.2019

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “IRARBA ENERGJI” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHËNGJUN” ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2040 KW.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 24.09.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes nr. 89/1 Prot, datë 09.09.2019, mbi licencimin e shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin Nr. 113, datë 22.07.2019, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për një afat 29 vjet e 1 muaj.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 32/35 Prot, datë 23.07.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 405/1 Prot, datë 08.08.2019 ka përcjellë pranë subjektit “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës si dhe mungesës së dokumentacionit të kërkuar.
- Shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405/2 Prot, datë 20.08.2019, ka paraqitur një pjesë të dokumentacionit të munguar dhe në vijim ERE i është drejtuar sërish me shkresën nr. 405/3 Prot, datë 29.08.2019, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të mbetur pa plotësuar për këtë aplikim.
- Në vijim shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k, me të sajën nr. 405/4 Prot, datë 03.09.2019, ka depozituar në ERE-s, dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., është një shoqëri koncesionare e krijuar në zbatim të nenit 8 të Kontratës së Koncesionit nr. 10335 Rep dhe nr. 3329 Kol, datë 09.09.2013, e lidhur midis METE (aktualisht MIE) dhe Bashkimit të Shoqërive “V & A ENERGJI KLOS” sh.p.k. dhe “AGRI Construction” sh.p.k. për ndërtimin e HEC “Shëngjun”, në rrethin Mat. Është rregjistruar në QKB, në datën 02.10.2013, konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit”, me NUIS L38402901A dhe mban statusin e Shoqërisë

me Përgjegjësi të Kufizuar. Kapitali themeltar prej 100.000 lekësh referuar ekstraktit të QKB të datës 08.05.2019, përbëhet nga ortakët “MARA – 2011” me 50% të aksioneve dhe “V & A ENERGJI KLOS” me 50% të aksioneve. Administrator i kësaj shoqërie është z. Bruno MARA.

- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti është : *“Kryerje e veprimtarisë së ndërtimit, operimit dhe transferimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali "SHENGJUN" tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike kjo në zbatim të kontratës së koncensionit nr. 10335 Rep dhe nr. 3329 Kol datë 09.09.2013, Kontrata e formës BOT (Ndërtim, Operim dhe Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "SHENGJUN" kontratë në të cilën përfshihet projektimi, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentralit dhe transferimin e tij tek autoriteti Kontraktues sipas kontratës së koncensionit, kontratës shtesë të koncensionit nr. 240 Rep dhe nr. 86 Kol, datë 05.04.2016, “Për disa ndryshime në kontratën e koncensionit të formës BOT (Ndërtim – Operim - Transferim), për ndërtimin e HEC-it “Shëngjun”, e ndryshuar.*
- Shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., ka depozituar 22 Çertifikata për Vërtetim Titulli “Në Përdorim”, të lëshuara nga ZRPP, të cilat vërtetojnë se shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., është rregjistruar si përdorues i pasurisë së paluajtshme shtetërore.
- Shoqëria ka parqitur Lejen e Këshillit të Basenit Ujor Mat, “Për përdorim të burimit ujor”, dhënë me Vendim nr. 6, datë 18.01.2019, e vlefshme deri në përfundimin e afatit të Kontratës së Koncensionit BOT. Kjo leje është dhënë me qëllim ndërtimin e HEC “Shëngjun” duke përdorur burimin ujor të Traverbangut, Përroit të Bejnit, degë e lumit Mat.
- Shoqëria ka depozituar në ERE Aktin e miratimit të Lejes së Mjedisit të Tipi B, me nr. 7488 Prot, datë 03.07.2014, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, lëshuar për shoqërinë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k për ndërtimin e HEC “Shëngjun” me kapacitet të instaluar 750 kW, me prodhim vjetor energjie 5 423 062 kWh/vit.
- Kjo leje rezulton të jetë lëshuar përpara miratimit të kontratës shtesë të koncensionit nr. 240 Rep dhe nr. 86 Kol, datë 05.04.2016, *“Për disa ndryshime në kontratën e koncensionit të formës BOT (Ndërtim – Operim - Transferim), për ndërtimin e HEC-it “Shëngjun”, e ndryshuar, të lidhur midis MIE dhe “IRARBA ENERGJI” sh.p.k, me anë të së cilës janë ndryshuar të dhënat që kanë të bëjnë me kapacitetin e instaluar të HEC-it, sasinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe vlerën e investimit.*
- Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, pas fillimit të procedurës i’u kërkua shoqërisë të përcjellë në ERE, Lejen Mjedisore të rinovuar në zbatim të ndryshimeve që solli kontrata shtesë e koncensionit nr. 240 Rep dhe nr. 86 Kol, datë 05.04.2016.
- Nga analizimi i dokumentave të depozituara nga shoqëria si plotësim, nuk rezulton të jetë depozituar Leja e Mjedisit e përditësuar.
- Në vijim me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405/4 Prot, datë 03.09.2019, shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k. ka përcjellë shkresën që ka depozituar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr. 16 Prot, datë 02.09.2019, *“Kërkesë për ndryshimin e parametrave energjistikë në Lejen e Mjedisit për HEC “Shëngjun”.*
- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k, rezulton se subjekti ka plotësuar kërkesat e *“Rregullores për procedurat dhe afatet*

për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gërmat a), b) c). Plotësuar
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gërmat a), b), c), d), e), f) g). Plotësuar
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gërmat a), b), c) d). Plotësuar.
- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, gërmat a), b), c), d) dhe pika 4.1.4, gërmat a), b), c), d), e). Plotësuar.
- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, gërmat a), b), c). Plotësuar.
- Shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., duhet të depozitojë në ERE Lejen Mjedisore me parametrat teknike të përditësuar, sipas ndryshimeve të Kontratës Shtesë të Koncesionit nr. 240 Rep dhe nr. 86 Kol, datë 05.04.2016, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (Ndërtim – Operim - Transferim), për ndërtimin e HEC-it “Shëngjun”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shëngjun” me kapacitet të instaluar 2040 kW, për një afat 29 vjet e 1 muaj, me kusht që, të depozitojë në ERE përpara fillimit të veprimtarisë së prodhimit, lejen mjedisore me parametrat teknike të përditësuar, sipas ndryshimeve të Kontratës Shtesë të Koncesionit nr. 240 Rep dhe nr. 86 Kol, datë 05.04.2016, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (Ndërtim–Operim-Transferim), për ndërtimin e HEC-it “Shëngjun”, i ndryshuar.
2. Të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto leje.
3. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti